



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 551/005
Dt 06.04.2018

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës, në mbledhjen e mbajtur më 30.3.2018, mori:

VENDIM

- I. Për kompensimin e diferencës së pagës prej 90 euro për periudhën 1.12.2017-13.2.2018 për drejtorin e zyrës për buxhet dhe financa dhe drejtorin e zyrës për çështje akademike, sipas nenit 4, pika 3 e Rregullores për unifikimin e të ardhurave personale të personelit administrativ të UMIB-it, nr. prot. 325/005, datë 09.03.2017, e cila është aprovuar për procedim nga Ministria e Financave më 1.12.2017 dhe ka qenë në fuqi deri më 13.2.2018 (vendimi nr. prot. 187/005, datë 13.02.2018).
- II. Të përmendurve iu takon diferenca e pagës prej 90 euro për këtë periudhë, e cila iu ka takuar në bazë të nenit 4, pika 3 e Rregullores, por që nuk është realizuar nga Ministria e Financave.
- III. Obligohet zyra për buxhet dhe financa për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Këshilli Drejtues, pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në UMIB për kompensimin e diferencës së pagës prej 90 euro për periudhën 1.12.2017-13.2.2018 për drejtorin e zyrës për buxhet dhe financa dhe drejtorin e zyrës për çështje akademike, sipas nenit 4, pika 3 e Rregullores për unifikimin e të ardhurave personale të personelit administrativ të UMIB-it, nr. prot. 325/005, datë 09.03.2017, e cila është aprovuar për procedim nga Ministria e Financave më 1.12.2017 dhe ka qenë në fuqi deri më 13.2.2018, e konsideroi të arsyeshëm dhe të bazuar propozimin, pasi Ministria e Financave nuk e ka realizuar pagën e të përmendurve sipas Rregullores që ka qenë në fuqi, duke marrë parasysh se deri në hyrjen në fuqi të Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në UMIB, nr. prot. 195 të datës 13.02.2018, të përmendurit kanë qenë pozita të drejtorëve të departamenteve (drejtor i Departamentit për Buxhet dhe Financa dhe Drejtor i Departamentit për Administratë të Përgjithshme). Bazuar në këtë që u cek më lartë, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. KZKA-së;
3. Zyrës për buxhet dhe financa;
4. Të përmendurve;
5. Zyrtarit të personelit.



Kryesuesi Këshillit Drejtues

Dr. sc. Sabri Sadiku